



MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL VLORE

Nr 4164 Prot

Vlorë më dt 24/09 / 2021

Lënda: Kthim-përgjigje

Drejtuar: Qendra "Res Publica"
Av. Dorian Matlija
Drejtor Ekzekutiv

Per dijeni: Komisioneri per te drejten e informimit dhe mbrojtjen e te dhenave personale

I nderuar!

Nisur nga e-maili "Sqarim ne lidhje me kerkesen me Nr.103/21 Prot.," drejtuar Spitalit Rajonal Vlore, me date 27.09.2021, protokolluar pranë Sekretarisë së Drejtorisë së Spitalit Rajonal Vlorë me Nr.4164 Prot. datë 27.09.2021, po ju japim informacionin e kerkuar sipas pikes 4 dhe 5 te kerkeses, duke Ju vendosur ne dispozicion dhe bashkelidhur dokumentacionin (kopje te kontratave) si me poshte:

- Marreveshje kuader me Nr.457/46 Prot., date 29.04.2020 me ane te se ciles Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale i delegon gjithë spitaleve te drejten per te lidhur kontratat.
- Kontrate furnizimi me Nr.566 date 10.02.2021 lidhur midis Spitalit Rajonal Vlore dhe bashkimit te perkohshem te operatoreve ekonomike GTS Gazra Teknik Shqiptar shpk dhe Messer Albagaz shpk.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Konc./Print.
Xh Tushaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 457/46 Prot.

Tiranë, më 29.04, 2020

MARRËVESHJE KUADËR
(KU TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
MALLRA

[Përdorimi i këtij draft marrëveshje është detyrues për të gjitha Autoritetet Kontraktore që do të përdorin marrëveshjen kuadër]

Nr. 457/46

DATA: 29.04 2020

Kjo kontratë lidhet me 29.04 2020, midis [M/S/M/S] tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe [emri dhe adresa e Kontraktuesit]: Bashkimi i Operatoreve ekonomikë GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk me NIPT J61905015 B Adresa: Tiranë, Vaqarr & Messer Albagaz shpk me NIPT K78317002 F Adresa: Tiranë, Vorë Autostrada Tiranë-Durrës, km-4.5 me përfaqësues GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk

të përfaqësuar nga [përfaqësuesit]:

1. GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk
- &
2. Messer Albagaz shpk

tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë 29.04.2020 bie dakord të furnizojë mallrat, ashtu siç janë të specifikuar në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë kontratë
- Formularin e Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formularin e çmimit të ofertës



Adresa: Rr e Kavajës Nr 1301, Tirana, Albania. Tel: +355 4 2362-937. www.shendetesia.gov.al



Gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbejnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

Neni 1 Objekti

1.1 Objekti i marrëveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/shërbimeve/punëve në vijim:

“B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Antituberkulare, Antineoplastike dhe immunomodulatore, antiparazitare, dermatologjike, hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut dhe Sistemi Respirator”, ndarë në 121 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave në total për të gjitha lotet për 24 muaj: 6,191,395,386 (gjashtë miliard e njëqind e nëntëdhjetë e një milion e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH.

Për lotet:

Lot/Principi aktiv	Formë - doza	Njësia	Sasi e planifikuar per 24 Muaj /lot	Vlera e pritshme e kontratave ne total per te gjitha AK (leke pa TVSH) /lot
Lot41 Oxygen	Gaz per pendorim mjeksor, i kompresuar x 100%	Litra	2,757,050	95,283,648
Lot42 Oxygen	Gaz per pendorim mjeksor, i lengershem x 100%	Litrn	3,048,300	412,969,052

- 1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marrëveshje. P.sh. kurdoherë që Autoriteti Kontraktor i përfshirë në këtë marrëveshje, do të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate, duhet që të dërgojë “flesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.
- 1.3 Sasitë e parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara.
- 1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësive, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.
- 1.5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër: 24 muaj



Adresa: Rr. e Kavajës Nr.1401, Tirana, Albania. Tel: +355 4 2262-937, www.shendetesia.gov.al



Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimet për njësi për punë/mallra /shërbime janë treguar në Formularin e Çmimit të Ofertës.
- 2.2 Çmimet e njërive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

Nënshkrimet dhe Datat

Për Kontraktuesin:

	BOE: GTS-Gazra Teknike Shpirtare shpk. NIPT J61905015 B & Messer A. bogori shpk. me NIPT K78317002 F me Kriqëgjësues GTS-Gazra Teknike Shpirtare shpk.
Emri	(GTS)
Pozita:	PËRfaqësues i autorizuar
Nënshkrimi:	[Signature]
Data:	
Vula:	
2. Emri	(Messer)
Pozita:	Përfaqësues
Nënshkrimi:	[Signature]
Data:	
Vula:	

Për Autoritetin Kontraktor

Emri:	Gelardina Prodani
Pozita:	Sekretar i Përgjithshëm Titullar i AK (OQB)
Nënshkrimi:	[Signature]
Data:	
Vula:	



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL VLORE

Nr. 366 prot.

Vlorë më 12.06.2021

KONTRATE FURNIZIMI

Nënshkruar sot më ____ / ____ 2021 në Vlorë ndërmjet palëve:

- ⇒ Spitali Rajonal Vlorë, qe me poshte do të emertohet *Autoriteti Kontraktor* përfaqësuar nga Znj. Brunilda Mersini, Drejtore e këtij Institucioni dhe
- ⇒ Bashkimit të perkohshëm të operatoreve ekonomikë (sipas kontrates së bashkepunimit Nr.697 Kol.Nr.82/3Kol. Date 29.03.2019) "GTS Gazra Teknik Shqiptar shpk" me NIPT J61905015B, me adrese; Kombinat Vaqarr Tirane (Shitesi) dhe Messer Albagaz shpk, me NIPT K78317002F, me adrese Autostrada Tirane-Durres Km 4.5, përfaqësuar respektivisht nga Përfaqësuesi ligjor Z. Besnik Halili dhe Z. Vladimir Vladimirov, qe me poshte do të emertohet "*Kontraktuesi*"

Kjo kontratë lidhet duke u mbështetur në Ligjin e Prokurimive Publike Nr. 9643 dt. 20. 11. 2006 „Per prokurimin Publik „te ndryshuar, nenet 59,60, V.K.M Nr.914 dt. 29. 12. 2014 „Për rregullat e Prokurimit Publik“ te ndryshuar, nenet 44,47/1,Vendimi Nr.135 date 20.02.2013 te Keshillit te Ministrave „Per lejimin e Ministrise se Shendetesise per kryerjen e procedurave te prokurimit publik ne emer dhe per llogari te institucioneve te varesise per disa mallra dhe sherbime“ si dhe ne Udhezimin e App-se Nr.6 date 16.01.2018“ Per perdorimin e marreveshjes kuader dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike“

Kontrata nënshkruhet mbas përfundimit të procedurës së prokurimit E Hapur me Urdher Prokurimi Nr.457Prot date 27.01.2020 :

"B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Antituberkulare, Antineoplastike dhe immunomodulatore, antiparazitare, dermatologjike, hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut dhe Sistemi Respirator", ndarë në 121 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj

Neni 1 – Objekti dhe vlera e kontrates.

- 1- Objekti i kontrates eshte furnizimi i Autoriteti Kontraktor me Oksigjen (Gaz per perdorim mjeksor, i kompresuar x 100%), sasia eshte **188 000 litra** ,cmimi per njesi eshte **34.56 leke/ liter** pa TVSH.

Aneksi 1

Nr Lot	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi/leke	Vlera/leke
41	Oksigjen i gazte mjeksore	litra	188000 lt	34.56	6 497 280
Vlera pa TVSH					

- 2- Vlera kontrates eshte **6 497 280 Leke** pa TVSH.
3- Afati i kontrates eshte deri ne perfundim te levrimet te sasise.
4- Cmimet nuk do te ndryshojne gjate kohes se vlefsherise se kontrates.
5- Furnizimi i Spitalit Rajonal Vlore do te mbulohet nga Operatori **Messer Albagaz shpk** bazuar ne Kontraten e Bashkepunimit mes 2 Operatoreve Nr360REP date 12.03.2020.

Neni 2 Kushtet e furnizimit.

- 1- Bombolat e oksigjenit duhet te shoqerohen me vertetimin e kryerjes se kontrolleve periodike te **Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna**, sipas percaktimeve ligjore.
- 2- Transporti i bombolave te oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet te bëhet me automjete të pajisur me :
- 2.1 Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial.
- 2.2 Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
- 2.3 Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.
- 3- Furnizimi do behet me bombola 40 ose 50 litra.
- 4- Operatori duhet te garantoje mbajtjen e nje sasie rezerve brenda vendit, 700 bombola, minimalisht per nevojat 15 ditore.
- Shenim: Oksigjeni i bombolave qe do te perdoren duhet te jete i regjistruar ne AKBPM per tregtim ne Republiken e Shqiperise.

- 5- Në cmim janë përfshirë të gjitha detyrimet fiskale dhe shpenzimet e transportit deri në destinacion. Transportimi i mallit deri në destinacion është detyrim i kontraktuesit ndërsa shkarkimi i mallit dhe ngarkimi i ambalazhit është detyrim i Autoritetit Kontraktor.

- 6- Njoftimet lidhur me kërkesat për furnizim, duhet të bëhen 2 ditë para në adresën e emailit elton.musa@messer.al ose me telefon 0682090905.

- 7- Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Neni 3 - Afatet e lëvrimit të oksigjenit gaz mjeksor: Sipas afatit të Marrvëshjes Kuader

- 1- Kontraktuesi është i detyruar të fillojë levrimin dhe dorezimin e mallit në deponë e Autoritetit Kontraktor sa herë që autoriteti kontraktore të ketë nevojë. Furnizimi bëhet sipas kërkesave dhe nevojave faktike të Spitalit Rajonal Vlorë.
- 2- Autoriteti Kontraktor është i detyruar të krijojë kushtet për marjen e mallit në dorezim me mbërritjen e tij në magazinën e tij.
- 3- A.K harton grafikët mujor të lëvrimit të mallit, një kopje e të cilit i jepet furnizuesit në fund të çdo muaji për muajin pasardhës. Në çdo rast duhet lajmëruar furnizuesi dy ditë më parë.
- 4- Si ditë e furnizimit do të konsiderohet data e mbërritjes së mallit në deponë e Autoritetit Kontraktor e cila për levrimin e parë do të jetë duke respektuar neni 3 pika 3, si më sipër.
- 5- Nëse Kontraktuesi vonon levrimin e mallit përtej afateve kontrate kohore të përcaktuara në kontratë, do të paguajë Autoritetit Kontraktor penalitetin 4/1000 të vlerës së për çdo ditë vonese.

Neni 4 - Zgjidhja e kontratës

Kontrata do zgjidhet ;

- 1- Kur vlera e penalitetit do të jetë e barabartë me vlerën e sigurimit të kontratës
- 2- Kur sasia dhe cilësia e mallit nuk do të jetë si ajo e ofruar në oferte nga shitesi, në aneksin 1 të kontratës.

Neni 5 - Dokumentat shoqeruese te mallit

Malli i furnizuar tek Autoriteti Kontraktor do te shoqerohet me faturen e shitjes te artikujve dhe me faturen e analizës .

Neni 6 - Cilesia e mallit

- 1- Mallrat e furnizuara do ti pergjigjen specifikimeve teknike dhe cilesore te percaktuara ne DST te kesaj procedure.

Neni 7 - Pagesat

- 1- Pagesa e mallrave do te kryhet nga Autoriteti Kontraktor Brenda 30 diteve nga data e furnizimit te mallit
- 2- Pagesa do te behet me lek shqiptar , me urdher xhirimi ne llogarine e shitesit(Messer Albagaz shpk). nr e llogarise bankare 0004293521 pranë Raiffaisen Bank IBAN AL-78202112880000000004293521
- 3- Dokumentat qe nevoiten per pagese jane ato te percaktuara ne Nenin 5 dhe flete – hyrja e Autoriteti Kontraktor .

Neni 8 -Cdemtimet

- 1.Cdo dorezim malli do te behet me procesverbal, ku do te percaktohet sakte numri i bombulave plote qe do te lihen ne perdorim te Autoritetit Kontraktor dhe numri i bombulave boshe qe do te terhiqen nga Operatori Ekonomik.
- 2.Ne rast konstatimi te demtimit apo humbjes se bombulave nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit eshte i detyruar te paguaje vleren 25000 lek.
- 3.Ne rast konstatimi te demtimit apo humbjes se ventilave nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit eshte i detyruar te paguaje vleren 2500 Leke.

Neni 9 – Vonesa ne pagese

Nese Autoriteti Kontraktor vonon pagesen e mallit ateherë ai detyrohet ti paguaje Kontraktuesit kamate vonesen, per cdo dite vones konvertohet ne perqindje e cila eshte e parashikuar ne ligj. Ne fund te vitit kamata e arritur i shtohet shumes totale, mbi te cilen eshte bere llogaritja e tyre

Neni 10 -Sigurimi i kontrates

Sigurimi i kontrates ne shumen prej 10% te vleres se kontrates duhet te ofrohet nga kontraktuesi per te siguruar realizimin e detyrimeve te tij sipas kontrates.

Neni 11 - Shuarja e mosmarveshjeve

Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet te bejne te gjitha perpjekjet per te zgjidhur me mirekuptim cdo mosmarveshje qe mund te linde ne lidhje me kete kontrate .

2. N. q . s. mosmareveshja vazhdon me tej secila pale mund te drejtohet per zgjidhje Gjykates se Rrethit .

3.Kjo kontrate behet ne kater kopje nga te cilat nje i jepet shitesit .

Ne kontrate do te jene te perfshira te gjitha kushtet e pergjitheshme dhe te vecanta te cilat jane e percaktuar ne DST.

SHITESI
GTS shpk Messer Albagaz shpk

PERFAQESUESI LIGJOR

Besnik Halili Vladimir Vladimirov

BLERESI
Spitali Rajonal Vlore

DREJTORE

Brunilda Mersini

Brunilda Mersini



MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL VLORE

1862

103/3

Nr 4116 Prot

Vlorë më dt 21/09/2021

Lënda: Kthim-përgjigje

Drejtuar: Qendra "Res Publica"
Av. Dorian Matlija
Drejtor Ekzekutiv

Per dijeni: Komisioneri per te drejten e informimit dhe mbrojtjen e te dhenave personale

I nderuar!

Mbështetur në kërkesën tuaj për informacion me Nr.1502/1Prot., të datës 14.09.2021 protokolluar pranë Sekretarisë së Drejtorisë së Spitalit Rajonal Vlorë me Nr.4032 Prot. datë 16.09.2021, po ju japim informacionin duke iu permbajtur pikave si me poshte :

- 1- Numri i pacienteve te shtruar dhe trajtuar ne Spitalin Rajonal Vlore me Covid-19 per vitet 2019/2020 dhe periudhen Janar-Qershor 2021.
 - Sipas strategjise vjeshte – dimer 2020-2021 te miratuar nga MSHMS, Spitali Rajonal Vlore ka qene pjese e skenarit (B) per tu hapur me pavione te dedikuara COVID sipas Planit te Veprimit te MSHMS. Sipas ketij skenari, shfrytezimi i kapaciteteve te disa prej spitaleve rajonale, nder te cilet edhe Spitali Rajonal Vlore, procesi i shfrytezimit te shtreterve spitalore rajonale do te filloje ne momentin e plotesimit te kapaciteteve te shtreterve te percaktuara ne skenarin A per spitalet rajonale COVID-19.
Ne skenarin B, kapaciteti i spitaleve rajonale eshte perlogaritur te jete me shfrytezim shtrati ne sherbimin spitalor dhe nen kujdesin sub-intensiv dhe intensiv, me pershkallezim.
Duke qene se nuk u ezauruan vendet perkatese te spitaleve COVID vendosur ne dispozicion te qytetareve sipas skenareve, ne Spitalin Rajonal Vlore eshte kryer triazhimi per 32 941 paciente.
- 2- Numri i pacienteve te infektuar me Covid-19 qe kane pasur nevojte per oksigjen medikal ne Spitalin Rajonal Vlore per vitet 2019/2020 dhe periudhen Janar –Qershor 2021.
 - Nisur nga numri i larte i rasteve per te cilat eshte bere triazhimi ne Spitalin Rajonal Vlore, plot 32 941 paciente, eshte praktikisht e pamundur te japim nje shifer ne lidhje me numrin e pacienteve qe kane pasur nevojte per oksigjen mjekesor. Cdo e dhene mbi pacientin gjendet ne kartelen perkatese mjekesore, ashtu sikurse edhe nese pacienti ka perdorur apo jo oksigjenin mjekesor. Ne keto kushte, eshte jashte mundesive te punonjeses se kartotekes te hape dhe te verifikoje nje numer te larte kartelash, plot 32 941 te tilla.

3- Numrin e operacioneve te kryera ne Spitalin Rajonal Vlore per vitet 2019/2020 dhe periudhen Janar-Qershor 2021.

- Ne Spitalin Rajonal Vlore nga 2019-2021 jane kryer me sukses 4 682 nderhyrje kirurgjikale.

4- Nje kopje te procedurave te tenderave te zhvilluar nga Spitali Rajonal Vlore per furnizimin me oksigjen medikal per vitet 2019/2020 dhe periudhen Janar-Qershor 2021.

- Ne lidhje me procedurat e prokurimit te zhvilluara per furnizimin me oksigjen medikal ju bejme me dije se keto procedura jane kryer nga Ministria e Shendetise dhe Mbrojtjes Sociale, dhe vetem nje procedure eshte kryer nga Spitali Rajonal Vlore, procedura te cilat jane te publikuara ne Agjencine e Prokurimit Publik.

5- Nje kopje te kontratave te lidhura nga Spitali Rajonal Vlore per furnizimin me oksigjen medikal per vitet 2019/2020 dhe periudhen Janar-Qershor 2021.

- Te gjitha kontratat e lidhura per furnizimin me oksigjen jane te aksesueshme ne faqen zyrtare te Agjencise se Prokurimit Publik.

Me ane te Marreveshjes Kuader me Nr.457/46 Prot., date 29.04.2020, Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale i delegon gjithe spitaleve te drejten per te lidhur kontratat. Per me teper informacion ne lidhje me kete pike, ju lutemi drejtohuni MSHMS.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Konc./Print.
Xh. Tushaj



DREJTORE

Brumilda MERSINI

